

## Termet e Referencës (ToR)

Zhvillimi i Vlerësimeve Lokale të Riskut nga Fatkeqësitë dhe Strategjive Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë dhe Qarkun Vlorë.

Forcimi i Qëndrueshmërisë së Shqipërisë nëpërmjet bashkë-zbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm Shumë-Rreziqesh (EAR-MHEWS)

0. Lista e shkurtimeve .....	2
1. Konteksti .....	3
Konteksti i Përgjithshëm .....	3
Konteksti i Vendit .....	3
Përmbledhje e Projektit .....	4
2. Detyrat që do të kryhen nga kontraktori .....	5
Kontakti dhe dispozita të tjera .....	9
3. Koncepti .....	10
Koncepti teknik-metodologjik .....	10
Menaxhimi i projektit nga kontraktori (1.6) .....	10
4. Koncepti i Personelit .....	11
Drejtuuesi i ekipit .....	11
Eksperti kyç 1 .....	11
Eksperti kyç 2 .....	12
Eksperti kyç 3 .....	12
Eksperti kyç 4 .....	12
Eksperti kyç 5 .....	13
Eksperti kyç 6 .....	13
Grupi i ekspertëve afatshkurtër .....	14
Eksperti kyç 7 .....	14
Eksperti kyç 8 .....	14
5. Kërkesat për kostimin .....	15
6. Kërkesat mbi formatin e ofertës .....	16

## 0. Lista e shkurtimeve

SIKPH	Sistemi i Informacionit Klimatik dhe Paralajmërimin të Hershëm
KMC	Komiteti i Mbrojtjes Civile
BZH	Bashkëpunimi për Zhvillim
EAR-MHEWS	Forcimi i Qëndrueshmërisë së Shqipërisë nëpërmjet bashkë-zbatimit të një Sistemi Kombëtar të Paralajmërimin të Hershëm Shumë-Rreziqesh (EAR-MHEWS)
EU CPM	Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i Bashkimit Evropian
GCF	Fondi i Gjellbër për Klimën
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
VLRF	Vlerësimi Lokal i Riskut nga Fatkeqësitë
ZLRF	Zvogëlimi Lokal i Riskut nga Fatkeqësitë
MHEWS	Sistemi Shumë-Rreziqesh i Paralajmërimin të Hershëm
MM	Ministria e Mbrojtjes
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
KKShK	Korniza Kombëtare për Shërbimet Klimatike
ShKMH	Shërbimi Kombëtar Meteorologjik dhe Hidrologjik
ToR	Termet e Referencës

## **1. Konteksti**

### **Konteksti i Përgjithshëm**

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është një agjenci në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes (ministra përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar) në Shqipëri. AKMC ushtron funksione koordinuese, mbikëqyrëse teknike, drejtuese dhe shërben si autoritet kombëtar kontrollues në fushën e reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile.

Qëllimi i Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe zbatimi i mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.

### **Konteksti i Vendit**

Shqipëria është e ekspozuar ndaj një sërë fatkeqësish natyrore, të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm mbi komunitetet, ekonominë, infrastrukturën dhe mjedisin. Rreziqet kryesore që prekin Shqipërinë janë tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e dheut, sëmundjet infektive dhe aksidentet teknologjike. Rreziqe të tjera përfshijnë stuhitë e dëborës, thatësitat, temperaturat ekstreme, ortekët dhe stuhitë e erës. Baza Ndërkombëtare e të Dhënave për Fatkeqësitë (EM-DAT) tregon se, gjatë periudhës 1979–2019, përmbytjet përbënin shumicën e ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%).

Cenueshmëria e popullsisë shqiptare ndaj fatkeqësive të shkallëve të mëdha dhe të vogla përkeqësohet nga varfëria, infrastruktura dhe komunikimet me cilësi të dobët, bumi i ndërtimeve dhe një sërë faktorësh mjedisorë të ndikuar nga aktiviteti njerëzor, që nga shpyllëzimi i shpejtë dhe menaxhimi i dobët i pellgjeve ujore deri te ndotja mjedisore. Për më tepër, niveli i edukimit dhe ndërgjegjësimit të popullsisë mbi këto risqe mbetet i ulët.

Të dhënat më të fundit tregojnë se Shqipëria është në mënyrë eksponenciale më e cenueshme ndaj fatkeqësive, pasi gjatë dekadës së fundit të gjitha rreziqet e sipërpërmendura janë shndërruar në një moment të caktuar në emergjenca ose fatkeqësi të shkallës së gjerë. Si rezultat i ekspozimit të lartë dhe kapaciteteve të pamjaftueshme për përballimin e tyre, fatkeqësitë po ndikojnë në rrugën e zhvillimit të Shqipërisë. Mesatarisht, dëmet nga tërmetet dhe përmbytjet vlerësohen në 147 milionë dollarë amerikanë në vit, ndërsa një ngjarje katastrofike, si p.sh. një tërmet që ndodh një herë në 100 vjet, mund të shkaktojë mbi 2 miliardë dollarë amerikanë dëme.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë të sistemit të menaxhimit të fatkeqësive, duke zhvendosur fokusin nga menaxhimi pasiv i situatave drejt një menaxhimi proaktiv, të orientuar drejt parandalimit dhe gatishmërisë. Përpjekje të koordinuara po ndërmerren nga Qeveria për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të fatkeqësive në vend, i cili do të jetë i gatshëm të përballet me të gjitha sfidat aktuale dhe të ardhshme.

Qeveria e Shqipërisë, duke iu përgjigjur detyrimeve të pranuar globalisht si pjesë e Kuadrit Sendai, duke aspiruar të bëhet një shtet anëtar i ardhshëm i Bashkimit Evropian dhe pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (EU CPM), por mbi të gjitha duke synuar që Shqipëria të bëhet një vend rezistent ndaj fatkeqësive, ka mbështetur fuqimisht zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (NDRRS), si gur themeli i të gjitha veprimeve të formalizuara për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe për përcaktimin e drejtimit strategjik të zhvillimeve të mëtejshme të sistemeve kombëtare.

Hartimi i strategjive kombëtare dhe lokale për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë është një nga shtatë objektivat e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015–2030.

## **Përmbledhje e Projektit**

Projekti “Forcimi i Qëndrueshmërisë së Shqipërisë nëpërmjet bashkë-zbatimit të një Sistemi Kombëtar Shumë-Rrezikësh të Paralajmërimit të Hershëm (EAR-MHEWS)” zbatohet nga AKMC dhe partnerët e saj kombëtarë, të cilët do të vendosin një sistem MHEWS të përshtatshëm për qëllimin, që adreson për herë të parë rreziqe të shumta klimatike në mënyrë të strukturuar, të koordinuar dhe të integruar. Shtrirja gjeografike e MHEWS do të jetë kombëtare, megjithëse nevojat specifike sipas riskut do të diferencohen gjeografikisht; për shembull, përmbytjet janë veçanërisht të theksuara në zonat e brezit bregdetar të prirura ndaj përmbytjeve.

Ky projekt është pjesë integrale e Programit të bashkëfinancuar nga Fondi i Gjellbër për Klimën (GCF) “Zhvillimi Urban Rezistent ndaj Klimës në Shqipëri” – ALBAdapt.

Fusha kryesore e programit ALBAdapt është adaptimi. ALBAdapt synon të rrisë qëndrueshmërinë klimatike të popullsisë shqiptare nëpërmjet gjenerimit, koordinimit dhe përdorimit efektiv të informacionit klimatik – të mbështetur nga një Shërbim Kombëtar funksional Meteorologjik dhe Hidrologjik (NMHS) dhe Korniza Kombëtare për Shërbimet Klimatike (NFCS) – si dhe nga një sistem shumë-rreziqesh i paralajmërimit të hershëm (MHEWS) me në qendër njerëzit, të cilat së bashku përbëjnë një sistem të integruar të informacionit klimatik dhe paralajmërimit të hershëm (CIEWS).

ALBAdapt ka 3 komponentë si më poshtë:

- Komponenti 1 – Shërbimi i informacionit meteorologjik, hidrologjik dhe klimatik
- Komponenti 2 – Sistemet shumë-rreziqesh të paralajmërimit të hershëm dhe veprimi i hershëm
- Komponenti 3 – Vendimmarrje për investime të informuara nga klima

Duke marrë në konsideratë kapacitetet e kufizuara teknike në nivel lokal, bashkitë kanë nevojë për asistencë të targetuar për të kuptuar më mirë kuadrin MHEWS, për të identifikuar dhe dokumentuar në mënyrë të saktë risqet, si dhe për të interpretuar të dhënat që lidhen me rreziqet për shpërndarjen e paralajmërimeve të hershme. Shumica e bashkive kanë shprehur, ndër të tjera, nevojën për mbështetje për të përmbushur kërkesat e ligjit për njësitë e qeverisjes vendore.

Duke marrë në konsideratë këto nevoja, AKMC do të nisë, në kuadër të projektit “EAR-MHEWS”, procesin për zhvillimin e dokumenteve të mëposhtme për bashkitë e Qarkut Vlorë:

- Vlerësimi Lokal i Riskut nga Fatkeqësitë (VLRf) (7 Bashki dhe Qarku)
- Strategjia Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SLZRF) (7 Bashki)

Hartimi i këtyre dokumenteve i përgjigjet detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe në Vendime të tjera të Këshillit të Ministrave, si dhe është në përputhje me dokumentin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut të AKMC-së, ku Qarku Vlorë identifikohet si një nga zonat prioritare për shkak të ekspozimit të lartë ndaj fatkeqësive natyrore dhe risqeve të lidhura me to.

Besohet se ky proces do të kontribuojë në krijimin e një standardi bashkiak që do të ndiqet dhe replikohet më tej. Mbi të gjitha, paketa e dokumenteve do të shërbejë si bazë për dokumentacionin e ardhshëm në nivel qarku mbi strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

## **2. Detyrat që do të kryhen nga kontraktori**

a. AKMC do të angazhojë kontraktorin për periudhën e parashikuar të kontratës, pas nënshkrimit të kontratës, me një kohëzgjatje prej 12 muajsh.

b. Kontraktori duhet të ofrojë shërbimet e mëposhtme: Zhvillimin e Vlerësimeve Lokale të Riskut nga Fatkeqësitë (VLRf) dhe Strategjive Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SLZRF) për Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë dhe Qarkun Vlorë, në Shqipëri.

Objekti i këtij angazhimi është zhvillimi i dokumenteve standarde bashkiake për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF), të harmonizuara me proceset kombëtare, nëpërmjet një qasjeje pjesëmarrëse që rrit ndërgjegjësimin, nxit angazhimin e aktorëve të interesit dhe mundëson hartimin e përbashkët të dokumenteve.

Objektivat specifike janë:

- Të kryhen Vlerësime Lokale gjithëpërfshirëse të Riskut nga Fatkeqësitë për Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë dhe Qarkun Vlorë, nëpërmjet identifikimit dhe analizimit të rreziqeve, vulnerabilitetit dhe ekspozimit, me fokus në zonat me risk të lartë dhe sektorët prioritarë.

- Të zhvillohen Strategjitë Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SLZRF), të integrohen konsideratat mbi riskun klimatik dhe të përcaktohen veprimet prioritare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe rritjen e qëndrueshmërisë për Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë.

*\*Të gjitha dokumentet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe dokumentacionin përkatës mbi Mbrojtjen Civile.*

Për të kthyer këto objektiva në veprime konkrete, angazhimi do të zhvillohet nëpërmjet fazave të mëposhtme të ndërlydhura:

**Zhvillimi i dokumenteve të Vlerësimit Lokal të Riskut nga Fatkeqësitë (VLRf):**

- Identifikimi i risqeve potenciale në territorin e Bashkive Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë dhe Qarkut Vlorë – duke përfshirë njohjen dhe përshkrimin e risqeve.
- Analiza e riskut, për të kuptuar më mirë dhe përcaktuar natyrën dhe nivelin e risqeve.
- Vlerësimi i riskut – për të krahasuar rezultatet e analizës së riskut me kriteret e riskut, me qëllim përcaktimin nëse risku dhe/ose niveli i tij është i pranueshëm ose i tolerueshëm.
- Vlerësimi i riskut i bazuar në GIS.

**Zhvillimi i Strategjive Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SLZRF) për Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë:**

- Hartimi i strategjisë në përputhje me vizionin e bashkive lidhur me risqet dhe rreziqet, i cili duhet të diskutohet dhe dakordësohet me aktorët vendorë të interesit.
- Zhvillimi i një plani veprimi – duke përfshirë masa afatshkurtra dhe afatgjata që kontribuojnë në objektivat strategjike të dokumenteve.
- Hartimi i një kuadri të detajuar monitorimi dhe raportimi për të siguruar ndjekjen e duhur të zbatimit.

*\*Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të miratohen nga këshillat bashkiakë përkatës, AKMC dhe programi ALBAdapt.*

Çdo fazë përfundon me një takim përmblyës fizik ose online, i kombinuar me komunikim të vazhdueshëm, takime dhe workshope me bashkitë, duke përfshirë grupe të ndryshme interesi me qëllim identifikimin e risqeve dhe masave të mundshme zbutëse për çështjet e evidentuara. Nga konsulenca priten versione draft, versione finale dhe produkte të dorzuara të rishikuara.

Dokumentet e Vlerësimit Lokal të Riskut nga Fatkeqësitë do të jenë në përputhje me metodologjitë kombëtare të aplikuara për secilin risk dhe të dhënat lokale do të mblidhen sipas strukturës së përditësuar të Vlerësimit Kombëtar të Riskut nga Fatkeqësitë. Ndërkohë, Strategjitë Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë duhet të jenë në përputhje me Strategjinë Kombëtare ZRF, Kuadrin Sendai dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Metodologjia e punës duhet të jetë pjesëmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë aktorët vendorë dhe ekspertizën e nevojshme. Aspektet pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse kërkohen për të siguruar një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës të ngritjes së kapaciteteve për aktorët vendorë, komunitetet dhe grupet vulnerabël (të rinjtë, të moshuarit, gratë, individët me aftësi të kufizuara, grupet etnike etj.).

Gjatë përgatitjes së dokumenteve, Konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë me bashkitë përkatëse, AKMC-në, Prefekturën, drejtoritë rajonale ose agjencitë përkatëse. Konsulenti duhet të bashkëpunojë me Komitetin e Mbrojtjes Civile (KMC) në nivel bashkie për të siguruar mbështetjen dhe miratimet e nevojshme gjatë procesit të zbatimit të aktiviteteve. Komiteti i Mbrojtjes Civile në nivel bashkie është një organ i përhershëm dhe, në rast se ende nuk është ngritur, do të jetë detyrë e Konsulentit të asistojë bashkinë në përgatitjen e Urdhrit përkatës të Kryetarit të Bashkisë dhe rregulloreve përkatëse në përputhje me Ligjin “Për

Mbrojtjen Civile”. Ky komitet do të jetë pjesë e grupit të punës për vlerësimin e riskut dhe strategjinë DRR, pasi do të sigurojë akses në të dhënat dhe informacionin ekzistues që lidhen me fushën e kërkuar të punës dhe do të mbështesë zbatimin me sukses të detyrës.

Bashkia, me mbështetjen e Prefektit, do të sigurojë çdo akses tjetër në të dhëna dhe informacion që lidhet me fushën e kërkuar të punës, do të krijojë marrëdhënie me institucionet lokale dhe qendrore kur të jetë e nevojshme dhe do të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme për zbatimin me sukses të detyrës.

Konsulenti duhet të dorëzojë produktet sipas afateve kohore të paraqitura në tabelën më poshtë. Kontraktori është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme dhe tabela më poshtë paraqet përmbledhjen e detyrave, produkteve për tu dorëzuar dhe afateve të pritshme të realizimit.

<b>Aktiviteti</b>	<b>Produktet e dorëzuara</b>	<b>Përmbajtja Kryesore</b>	<b>Formati /Afati</b>
Detyra 1. Faza Fillestare, takimi hapës dhe planifikimi i punës (Vendosja e bazës së punës)	1.1 Raporti Fillestar 1.2 Metodologjia (produkt i përbashkët) 1.3 Hartëzimi i Palëve të Interesit 1.4 Raport Analize dhe Rishikimi 1.5 Dokumentacioni i Takimeve  (Të gjitha produktet e dorëzuara duhet të ofrohen bazuar në planin e punës)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodologjia e propozuar për përgatitjen e paketës së dokumenteve për 7 bashki dhe Qarkun Vlorë, duke përfshirë strukturën e propozuar të ekipit të ekspertëve.</li> <li>• Plani i punës që mbulon zhvillimin e paketës së dokumenteve për 7 bashki dhe Qarkun Vlorë (aktivitetet kryesore, përmbajtjen, afatet kohore, fazat dhe ndërlidhjen e tyre, përgjegjësitë e ekipit dhe koordinimin), në përputhje me qasjen teknike dhe metodologjinë.</li> <li>• Takime hapëse (8) me autoritetet dhe palët e interesit në Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë për prezantimin e objektivave, konfirmimin e angazhimit dhe grupeve të punës, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të qasjes.</li> <li>• Rishikimi i planeve ekzistuese lokale, të dhënave përkatëse, raporteve, vlerësimeve (përfshirë dokumente të palëve të treta, p.sh. nga projekte të financuara nga donatorë, OJF lokale etj.) për të mbështetur detyrat pasuese.</li> </ul>	MS Word/  Raporti Fillestar Metodologjia Hartëzimi i Palëve të Interesit Raporti i Analizës dhe Rishikimit Procesverbale t e Takimeve  Kërkohet gjithashtu një përmbledhje e produktit të dorëzuar në format PPT (minimumi 5–10 slide).  <b>Muaji 1 – 2</b>
Detyra 2. Zhvillimi i Vlerësimeve Lokale të Riskut nga Fatkeqësitë	2.1 Dokumentet e Vlerësimit Lokal të Riskut nga Fatkeqësitë për Vlorën, Selenicën, Himarën, Sarandën,	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e situatës ekzistuese lokale, nevojave dhe boshllëqeve, duke u mbështetur në informacionin dhe kapacitetet ekzistuese.</li> </ul>	MS Word/  Struktura e dokumentit Draft-dokumentet

	<p>Konispolin, Finiqin, Delvinën dhe Qarkun Vlorë (8 dokumente)</p> <p>2.2 Dokumentacioni i Takimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i rreziqeve të mundshme, vulnerabilitetit, ekspozimit dhe kapaciteteve përballuese të komuniteteve.</li> <li>• Përcaktimi i natyrës, vendndodhjes, intensitetit dhe probabilitetit të risqeve kryesore specifike për territorin.</li> <li>• Vlerësimi i probabilitetit të ndodhjes dhe dëmeve të mundshme për risqe specifike.</li> <li>• Identifikimi i popullsisë dhe aseteve në risk, si dhe i zonave të prirura ndaj fatkeqësive.</li> <li>• Vlerësimi i kapaciteteve të elementeve në risk për t'i rezistuar skenarëve të caktuar të risqeve.</li> <li>• Identifikimi i opsioneve për zvogëlimin e riskut duke marrë në konsideratë arsyeshmërinë, efektivitetin e kostos, praktikueshmërinë e masave dhe kapacitetet ekzistuese.</li> <li>• Ofrimi i informacionit për strategjitë bashkiake ZRF dhe Planet e Veprimt, të cilat do të përdorin gjetjet mbi rreziqet, riskun, ekspozimin dhe vlerësimet e kapaciteteve përballuese.</li> <li>• Ofrimi i informacionit për vlerësimin e kapaciteteve që i nevojiten komunitetit. Ky proces do të mbështesë planet lokale të emergjencës në përdorimin e rezultateve të vlerësimit të riskut për të përcaktuar faktorët e planifikimit dhe nivelet e nevojshme të kapaciteteve.</li> <li>• 2 takime konsultimi për secilën nga 7 bashkitë dhe Qarkun Vlorë.</li> <li>• Workshop konsultimi me palët e interesit mbi draft-dokumentet e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë të identifikuara për secilën bashki. Kërkohen procesverbalet e takimeve dhe dokumentimi i pjesëmarrësve (të ndarë sipas gjinisë), si dëshmi e procesit pjesëmarrës.</li> </ul>	<p>Dokumentet finale</p> <p>Kërkohet gjithashtu një përmbledhje e produktit të dorëzuar në format PPT (minimumi 5–10 slide).</p> <p><b>Muaji 2 – 7</b></p>
<p>Detyra 3.1 e Përgatitja e Hartave</p>	<p>3.1 Hartat e Riskut (për secilën bashki)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për secilën bashki, duke paraqitur zonat në risk nga rreziqet klimatike, bazuar në informacionin e marrë në kuadër të Detyrës 2 (Vlerësimet Lokale të</li> </ul>	<p>Format i kombinuar PDF për hartat (për të</p>

	3.2 Dokumentacioni i Takimeve	<p>Riskut nga Fatkeqësitë për secilën bashki përkatëse).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Caktimi i pikëzimeve për probabilitetin dhe ndikimin, paraqitja në një matricë/grid, përdorimi i kodimit me ngjyra sipas nivelit të rëndësisë dhe zhvillimi i strategjive të mitigimit.</li> </ul>	<p>shtatë bashkitë)</p> <p><b>Muaji 6</b></p>
Detyra 4. Zhvillimi i Strategjive Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë	<p>4.1 Strategjitë Lokale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për Bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë (7 dokumente)</p> <p>4.2 Dokumentacioni i Takimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e kuadrit politik, institucional, ligjor dhe menaxhues.</li> <li>• Bazuar në informacionin e marrë në kuadër të Detyrës 2 (Vlerësimet Lokale të Riskut nga Fatkeqësitë për secilën bashki përkatëse), identifikimi i vizionit, misionit, objektivave strategjikë dhe listës së projekteve që kontribuojnë në objektivat strategjikë dhe vizionin e bashkive.</li> <li>• Identifikimi i fushave kyçe të ndërhyrjes për menaxhimin e risqeve ekzistuese dhe parandalimin e risqeve të reja, si dhe forcimin e kapaciteteve të reagimit.</li> <li>• Identifikimi i listës së masave për realizimin e secilit projekt strategjik. Masat mund të jenë masa organizative, masa jostrukturore ose masa strukturore, të shoqëruara me vlerësimin e afateve, indikatorëve, kostove dhe identifikimin e përgjegjësive institucionale përkatëse për zbatimin e tyre.</li> <li>• Kuadri i Monitorimit dhe Raportimit, i cili duhet të bazohet në indikatorë konkretë të zhvilluar për secilën masë.</li> <li>• Organizimi i 3 takimeve konsultuese për secilën nga 7 bashkitë.</li> <li>• Workshope konsultimi me palët e interesit mbi draft-strategjitë e identifikuar për secilën bashki. Kërkohen procesverbalet e takimeve dhe dokumentimi i pjesëmarrësve (të ndarë sipas gjinisë), si dëshmi e procesit pjesëmarrës.</li> </ul>	<p>MS Word</p> <p>Struktura e dokumentit Draft-strategjitë Strategjitë finale</p> <p>Kërkohet gjithashtu një përmbledhje e produktit të dorëzuar në format PPT (minimumi 5–10 slide).</p> <p><b>Muaji 8 – 11</b></p>
Detyra 5. Eventi Përmbyllës dhe Raportimi i Konsulencës	<p>5.1 Prezantimi i dokumenteve në nivel qarku</p> <p>5.2 Raporti final i konsulencës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultatet e konsulencës dhe produktet e dorëzuara do të prezantohen në një workshop final të organizuar në Qarkun Vlorë.</li> <li>• Raportimi i detyrave, rezultateve të arritura dhe mësimëve të nxjerra.</li> </ul>	<p>MS Word</p> <p>Raporti final</p> <p>Kërkohet gjithashtu një përmbledhje e</p>

			produkteve të dorëzuara në format PPT (minimumi 5–10 slide).  <b><i>Muaji 12</i></b>
--	--	--	--

Kontakti dhe dispozita të tjera

Komunikimi për këtë angazhim do të kryhet nëpërmjet [info.ear-mhews@akmc.gov.al](mailto:info.ear-mhews@akmc.gov.al)

Të gjitha produktet e dorëzuara duhet të paraqiten në gjuhën shqipe dhe angleze nëpërmjet e-mailit në adresën [info.ear-mhews@akmc.gov.al](mailto:info.ear-mhews@akmc.gov.al)

## Terms of reference (ToR)

### 3. Koncepti

Në ofertë, ofertuesit i kërkohet të tregojë se si do të arrihen objektivat e përcaktuara në tabelën e Detyrave që do të kryhen, sipas rastit duke marrë në konsideratë kërkesa të tjera që lidhen me metodologjinë (koncepti teknik-metodologjik). Përveç kësaj, ofertuesi duhet të përshkruajë sistemin e menaxhimit të projektit për ofrimin e shërbimeve.

**Shënim:** Numrat në kllapa korrespondojnë me rreshtat e grid-it të vlerësimit teknik.

#### Koncepti teknik-metodologjik

**Strategjia (1.1):** Ofertuesit i kërkohet të marrë në konsideratë detyrat që duhet të kryhen, siç kërkohen në mënyrë eksplicite në përshkrimin e detyrave, nëpërmjet objektivave të shërbimeve të nxjerra në tender (1.1.1). Në vijim, ofertuesi paraqet dhe justifikon strategjinë konkrete me të cilën synon të ofrojë shërbimet për të cilat është përgjegjës (1.1.2).

**Bashkëpunimi (1.2):** Ofertuesit i kërkohet të marrë në konsideratë mënyrën e bashkëpunimit me përfituesit dhe të paraqesë ndërveprimet me aktorët përkatës (1.2.1) në kuadër të ofertës teknike. Përveç kësaj, kërkohet një strategji e shkurtër bashkëpunimi (1.2.2) për të kuptuar se si do të realizohet bashkëzhvillimi i këtyre dokumenteve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkive lokale, Prefekturës, Drejtorive dhe Agjencive rajonale, OJF-ve, aktorëve të tjerë lokalë, si dhe Komitetit të Mbrojtjes Civile, i cili është grupi i punës për përgatitjen e paketës së dokumenteve, i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të bashkive përkatëse.

Ofertuesit i kërkohet të përshkruajë proceset kyçe për shërbimet për të cilat është përgjegjës dhe të hartojë një Plan Veprimi (1.4.1), i cili përshkruan mënyrën se si do të ofrohen shërbimet sipas Detyrave që do të kryhen nga kontraktori. Në veçanti, ofertuesit i kërkohet të përshkruajë hapat e nevojshëm të punës dhe, sipas rastit, të marrë në konsideratë momentet kyçe dhe kontributet e aktorëve të tjerë (kontributet e partnerëve), në përputhje me Detyrat që do të kryhen (1.4.2).

Ofertuesit i kërkohet të përshkruajë (1.5) mënyrën se si do të promovohen efektet e zgjerimit dhe replikimit (1.5.2), veçanërisht të lidhura me progresin afatgjatë të masave të adaptimit në lidhje me harmonizimin me politikat kombëtare të adaptimit, në kuadër të të nxënimit dhe inovacionit.

#### Menaxhimi i projektit nga kontraktori (1.6)

Ofertuesit i kërkohet të shpjegojë qasjen e tij për koordinimin me projektin. Në veçanti, kërkesat për menaxhimin e projektit të specifikuar në Detyrat që do të kryhen nga kontraktori duhet të shpjegohen në mënyrë të detajuar.

Ofertuesit i kërkohet të hartojë një plan të angazhimit të personelit, të shoqëruar me shënime shpjeguese, ku të listohen të gjithë ekspertët e propozuar në ofertë; plani duhet të përfshijë informacion mbi datat e angazhimit (kohëzgjatjen dhe muajt e ekspertëve) dhe vendndodhjet e secilit anëtar të ekipit, së bashku me shpërndarjen e hapave të punës sipas planifikimit të përcaktuar.

Ofertuesit i kërkohet të përshkruajë konceptin e tij të backstopping-ut.

## Kërkesat e Tenderit

Vlerësimi për këtë tender do të kryhet bazuar në ofertën financiare (30%) dhe Propozimin Teknik dhe CV-të (70%).

## Eksperienca teknike

### Eksperienca teknike (deri në pesë fusha të specializuara, përfshirë temat ndërsektoriale) Pikë

Eksperienca në fushën e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF) /Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike	15
Eksperienca në Inxhinieri Mjedisore	10
Eksperienca në Planifikim Hapësinor	10
Eksperienca në Hartëzimin e Riskut	10
Eksperienca në Zhvillim Ekonomik Vendor	15
Eksperienca Rajonale	5
Eksperienca në projekte zhvillimi (minimumi 50% të financuara nga ODA)	5
<b>Totali i Vlerësimit Teknik</b>	<b>70</b>
<b>Oferta Financiare</b>	<b>30</b>
<b>Totali</b>	<b>100</b>

## Rregullat e Vlerësimit

- Për t'u kualifikuar për vlerësimin financiar, ofertuesi duhet të sigurojë minimumi 50 pikë në vlerësimin teknik.
- Vlerësimi i ofertës financiare do të kryhet sipas formulës:

$$\text{Pikët financiare} = (\text{Oferta më e ulët} / \text{Oferta në vlerësim}) \times 30$$

- Kontrata do t'i jepet ofertuesit që siguron numrin më të lartë të pikëve totale (teknike + financiare).

## 4. Koncepti i Personelit

Ofertuesit i kërkohet të propozojë personel të përshtatshëm për plotësimin e pozicioneve të përshkuara, bazuar në CV-të e tyre, gamën e detyrave të përfshira dhe kualifikimet e kërkuara.

Kualifikimet e specifikuar më poshtë përfaqësojnë kërkesat për të arritur numrin maksimal të pikëve në vlerësimin teknik.

## Drejtuesi i Ekipit

Kualifikimet e drejtuesit të ekipit

Përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe kontrollin e cilësisë së produkteve të dorëzuara. Ai/Ajo pritet të ofrojë udhëzim dhe drejtim për ekipin e ekspertëve me qëllim realizimin e detyrave të caktuara. Drejtuesi i Ekipit do të jetë gjithashtu përgjegjës për dorëzimin final të produkteve dhe do të veprojë si përfaqësuesi kryesor me bashkinë dhe AKMC-në.

- Arsimi/trajnimi (2.1.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe/ose çdo fushë tjetër studimi që lidhet me Ndryshimet Klimatike/Adaptimin.
- Gjuha (2.1.2): Nivel i aftësisë gjuhësore C1 në gjuhën angleze.
- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.1.3): Të paktën 7 vite eksperiencë profesionale të provuar në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve komplekse, punëve/projekteve të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë, zhvillimin dhe përdorimin e mjeteve të vlerësimit të riskut dhe/ose vlerësimeve të rreziqeve dhe ndikimeve për vendimmarrje të bazuar në evidenca në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
- Eksperienca specifike profesionale (2.1.4): 5 vite eksperiencë në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, duke përfshirë projektimin dhe zbatimin e projekteve përkatëse në nivel kombëtar/lokal.
- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.1.5): Të paktën 3 vite në rol drejtues në projekte komplekse të Menaxhimit të Riskut nga Fatkeqësitë.
- Eksperienca rajonale (2.1.6): 3 vite eksperiencë në koordinimin e parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë në kontekst rajonal.
- Eksperienca në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.1.7): Të paktën 2 vite eksperiencë në projekte të Bashkëpunimit për Zhvillim (DC).
- Të tjera (2.1.8):
  - Njohuri dhe eksperiencë në planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.
  - Eksperiencë në bashkëpunimin me agjenci qeveritare, autoritete lokale, OJF dhe aktorë të tjerë përkatës për të siguruar një qasje të koordinuar.
  - Aftësi të shkëlqyera menaxheriale dhe koordinuese.
  - Aftësi të shkëlqyera analitike.

## **Eksperti kryesor 1**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 1 – Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Përmbytjet

- Arsimi/trajnimi (2.2.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Inxhinieri Hidrologjike dhe/ose Hidraulike, Meteorologji, Menaxhim Risku ose çdo fushë tjetër të lidhur studimi.
- Gjuha (2.2.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.
- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.2.3): 7 vite eksperiencë profesionale në fushën e vlerësimit të riskut nga përmbytjet dhe menaxhimit të ujërave.
- Eksperienca specifike profesionale (2.2.4): 5 vite eksperiencë të provuar në aktivitete të menaxhimit të fatkeqësive nga përmbytjet në nivel lokal dhe/ose rajonal.
- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.2.5): Të paktën 1 vit eksperiencë në punën me ekipe planifikimi multidisiplinare.
- Eksperienca rajonale (2.2.6): E lidhur me evente dhe aktivitete të menaxhimit të riskut nga përmbytjet.

- Eksperienca në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.2.7): Do të konsiderohet vlerë e shtuar.
- Të tjera (2.2.8): Ekspertizë teknike e provuar që lidhet me detyrat e këtij angazhimi.

### **Eksperti kryesor 2**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 2 – Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Rrëshqitjet e Dherave dhe Riskut Sizmik

- Arsimi/trajnimi (2.2.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Inxhinieri Civile/Strukturore, Sizmologji, Inxhinieri Gjeoteknike ose çdo fushë tjetër të lidhur studimi.
- Gjuha (2.2.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.
- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.2.3): 7 vite eksperiencë profesionale në vlerësimin e rrezikut dhe riskut sizmik, përfshirë rrëshqitjet e dherave.
- Eksperienca specifike profesionale (2.2.4): 5 vite eksperiencë në menaxhimin e rrezikut dhe riskut sizmik, përfshirë aktivitetet që lidhen me rrëshqitjet e dherave në nivel lokal dhe/ose rajonal.
- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.2.5): 1 vit eksperiencë në punën me ekipe planifikimi multidisiplinare.
- Eksperienca rajonale (2.2.6): Eksperiencë e lidhur drejtpërdrejt me vlerësimin sizmik dhe të rrëshqitjeve të dherave në nivel rajonal.
- Të tjera (2.2.8): Ekspertizë teknike e provuar që lidhet me detyrat e këtij angazhimi.

### **Eksperti kryesor 3**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 3 – Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Zjarret në Pyje

- Arsimi/trajnimi (2.2.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Ekologji Pyjore, Menaxhim Pyjor, Studime Mjedisore.
- Gjuha (2.2.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.
- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.2.3): 7 vite eksperiencë profesionale në fushën e pylltarisë dhe menaxhimit të zjarreve në pyje.
- Eksperienca specifike profesionale (2.2.4): 5 vite eksperiencë në kontekstin e zjarreve në pyje dhe aktiviteteve që lidhen me risqet nga ndryshimet klimatike në nivel lokal dhe/ose rajonal.
- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.2.5): 1 vit eksperiencë në punën me ekipe planifikimi multidisiplinare.
- Eksperienca rajonale (2.2.6): Eksperiencë e provuar në aktivitete të drejtpërdrejta për menaxhimin e zjarreve në pyje në nivel rajonal.

- Eksperienca në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.2.7): Eksperienca në projekte DC do të konsiderohet vlerë e shtuar.

- Të tjera (2.2.8):

- Aftësi të shkëlqyera analitike.
- Ekspertizë teknike e provuar që lidhet me detyrat e këtij angazhimi.

#### **Eksperti kryesor 4**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 4 – Ekspert për Riskun Teknologjik dhe Industrial

- Arsimi/trajnimi (2.4.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Inxhinieri Kimike, Inxhinieri Bioteknologjike, Inxhinieri Biokimike ose çdo fushë tjetër të lidhur studimi.

- Gjuha (2.4.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.

- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.3.3): 7 vite eksperiencë në sektorin industrial dhe në vlerësimin e riskut, si dhe në menaxhimin e rreziqeve teknologjike.

- Eksperienca specifike profesionale (2.3.4): 5 vite eksperiencë të provuar në ekspertizë teknike për menaxhimin e fatkeqësive nga rreziqet teknologjike.

- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.4.5): Eksperiencë në menaxhimin e proceseve të caktuara në institucione/projekte të ndryshme.

- Eksperienca rajonale (2.4.6): Eksperiencë e provuar në menaxhimin e fatkeqësive nga rreziqet teknologjike në kontekst rajonal.

- Eksperienca në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.4.7): Eksperienca në projekte DC do të konsiderohet vlerë e shtuar.

- Të tjera (2.4.8):

- Aftësi të shkëlqyera analitike.
- Ekspertizë teknike e provuar që lidhet me detyrat e këtij angazhimi.

#### **Eksperti kryesor 5**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 5 – Ekspert për Riskun Biologjik dhe Sëmundjet Infektive

- Arsimi/trajnimi (2.4.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Inxhinieri Biologjike/Bioteknologjike/Biokimike, Biologji, Mikrobiologji ose çdo fushë tjetër të lidhur studimi.

- Gjuha (2.4.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.

- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.3.3): 7 vite eksperiencë në fushën e shëndetit publik.

- Eksperienca specifike profesionale (2.3.4): 5 vite eksperiencë të provuar në ekspertizë teknike për menaxhimin e fatkeqësive nga rreziqet biologjike.

- Eksperiencia në drejtim/menaxhim (2.4.5): Eksperiencë në menaxhimin e proceseve të caktuara në institucione/projekte të ndryshme.
- Eksperiencia rajonale (2.4.6): Eksperiencë e provuar në menaxhimin e fatkeqësive nga rreziqet biologjike në kontekst rajonal.
- Eksperiencia në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.4.7): Eksperiencia në projekte DC do të konsiderohet vlerë e shtuar.
- Të tjera (2.4.8):
  - Aftësi të shkëlqyera analitike.
  - Ekspertizë teknike e provuar që lidhet me detyrat e këtij angazhimi.

## **Eksperti kryesor 6**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 6 – Ekspert GIS dhe Hartëzimit të Riskut

- Arsimi/trajnimi (2.2.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në disiplina gjeohapësinore me profil GIS.
- Gjuha (2.2.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.
- Eksperiencia e përgjithshme profesionale (2.2.3): 7 vite eksperiencë profesionale në ofrimin e produkteve të lidhura me GIS për projekte mjedisore.
- Eksperiencia specifike profesionale (2.2.4): 3 vite eksperiencë në DRR/hartëzimin e ekspozimit.
- Eksperiencia rajonale (2.2.6): Eksperiencë në hartëzimin e riskut në kontekst rajonal.
- Eksperiencia në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.2.7): Eksperiencia në projekte DC do të konsiderohet vlerë e shtuar.
- Të tjera (2.2.8):
  - Aftësi në dizajn kartografik.
  - Aftësi të shkëlqyera analitike.

Grupi i ekspertëve afatshkurtër

Për vlerësimin teknik, do të llogaritet mesatarja e kualifikimeve të të gjithë anëtarëve të specifikuar të grupit të ekspertëve. Ju lutemi të dërgoni një CV për secilin anëtar të grupit (shih Kapitullin 7 – Kërkesat mbi formatin e ofertës) për qëllime vlerësimi.

## **Eksperti kryesor 7**

Kualifikimet e ekspertit kryesor 7 – Ekspert Socio-Ekonomik (me integrim të perspektivës gjinore)

- Arsimi/trajnimi (2.3.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Ekonomi, Socio-Ekonomi ose Ekonomi Zhvillimi, Administrim dhe Qeverisje Publike ose çdo fushë tjetër të lidhur studimi.
- Gjuha (2.3.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.
- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.3.3): 7 vite eksperiencë në analizë socio-ekonomike, zhvillim ekonomik lokal, zhvillim strategjish (analizë dhe identifikim i vlerave lokale, potencialit ekonomik dhe kapaciteteve lokale), si dhe njohuri dhe eksperiencë pune në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
- Eksperienca specifike profesionale (2.3.4): 5 vite eksperiencë pune me qeverisjen vendore, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe financimin publik dhe investimet për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.3.5): Eksperiencë në menaxhimin e proceseve të caktuara në institucione publike.
- Eksperienca rajonale (2.3.6): Njohuria dhe eksperienca e punës në kontekst rajonal do të konsiderohet vlerë e shtuar.
- Eksperienca në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.3.7): Eksperienca në projekte DC do të konsiderohet vlerë e shtuar.
- Të tjera (2.3.8):
  - Eksperiencë në menaxhim financiar.
  - Eksperiencë në analizën e efektivitetit të kostos.
  - Eksperiencë pune me grupet vulnerabël dhe integrimin e perspektivës gjinore.

## **Eksperti kryesor 8**

### Kualifikimet e ekspertit kryesor 8 – Ekspert për Zhvillimin Lokal

- Arsimi/trajnimi (2.4.1): Diplomë Bachelor/Master (ose ekuivalente 5-vjeçare) në Ekonomi, Zhvillim, Administrim Publik ose çdo fushë tjetër të lidhur studimi.
- Gjuha (2.4.2): Nivel i aftësisë gjuhësore B2 në gjuhën angleze.
- Eksperienca e përgjithshme profesionale (2.3.3): 7 vite eksperiencë në zhvillim ekonomik lokal, analizë dhe identifikim të vlerave lokale, faktorëve dhe mundësive ekonomike, potencialeve zhvillimore dhe kapaciteteve lokale.
- Eksperienca specifike profesionale (2.3.4): 5 vite eksperiencë të provuar në punën me qeverisjen vendore dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.
- Eksperienca në drejtim/menaxhim (2.4.5): Eksperiencë në menaxhimin e proceseve të caktuara në institucione/projekte të ndryshme.
- Eksperienca rajonale (2.4.6): Eksperiencë e provuar në projekte të zhvillimit lokal në kontekst rajonal.

- Eksperienca në Bashkëpunimin për Zhvillim (DC) (2.4.7): Eksperienca në projekte DC do të konsiderohet vlerë e shtuar.

- Të tjera (2.4.8):

- Aftësi të shkëlqyera analitike.
- Ekspertizë teknike e provuar që lidhet me detyrat e këtij angazhimi.

Aftësitë e buta të anëtarëve të ekipit

Përveç kualifikimeve profesionale, nga anëtarët e ekipit kërkohen edhe kualifikimet e mëposhtme:

- Aftësi pune në ekip;
- Iniciativë;
- Aftësi komunikimi;
- Aftësi socio-kulturore;
- Metoda pune efikase, të orientuara drejt partnerit dhe klientit;
- Mendim ndërdisiplinor.

## 5. Kërkesat për Kostimin

### Specifikimi i inputeve

Ditë pune	Numri i ekspertëve	Numri i ditëve për ekspert	Totali	Komente
Drejtuuesi i Ekipit	1	80		
Eksperti Kryesor 1 – Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Përmblytjet	1	40		
Eksperti Kryesor 2 – Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Rrëshqitjet e Dherave dhe Riskut Sizmik	1	40		
Eksperti Kryesor 3 – Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Zjarret në Pyje	1	40		
Eksperti Kryesor 4 – Ekspert për Riskun Teknologjik dhe Industrial	1	30		
Eksperti Kryesor 5 – Ekspert për Riskun Biologjik dhe Sëmundjet Infektive	1	30		
Eksperti Kryesor 6 – Ekspert GIS dhe Hartëzimit të Riskut	1	60		
Eksperti Kryesor 7 – Ekspert Socio-Ekonomik	1	30		

Eksperti Kryesor 8 – Ekspert për Zhvillimin Vendor	1	30		
<b>Shpenzime udhëtimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Numri për ekspert</b>	<b>Totali</b>	<b>Komente</b>
Dieta ditore brenda vendit të zbatimit	N/A	N/A	N/A	
Shpenzime akomodimi brenda vendit të zbatimit	N/A	N/A	N/A	
<b>Transport</b>	<b>Sasia</b>	<b>Numri për ekspert</b>	<b>Totali</b>	<b>Komente</b>
Fluturime ndërkombëtare	N/A	N/A	N/A	
Fluturime të brendshme	N/A	N/A	N/A	
Kompensimi CO2 për udhëtimet ajrore	N/A	N/A	N/A	
Shpenzime transporti (tren, automjet, etj.)	Përcaktohet nga konsulent i sipas nevojave të zbatimit	Përcaktohet nga konsulenti sipas pjesëmarrësve në udhëtim	Deri në ____ km	Bazuar në udhëtimet vajtje-ardhje të nevojshme për realizimin e detyrave dhe aktiviteteve të kontratës, duke marrë Tiranën si pikë reference dhe duke konsideruar rastet e nevojshme të kombinimit të udhëtimeve.
<b>Kosto të tjera</b>	<b>Numri</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Totali</b>	<b>Komente</b>
Pagesë fleksibël	N/A	N/A	N/A	

## 6. Kërkesat mbi formatin e ofertës

Struktura e ofertës duhet të korrespondojë me strukturën e Termave të Referencës (ToR). Në veçanti, struktura e detajuar e konceptit (Kapitulli 3) duhet të organizohet në përputhje me kriteret e vlerësimit që kanë peshë pozitive në grid-in e vlerësimit (jo ato me zero). Oferta duhet të jetë e lexueshme (madhësia e shkronjave 11 ose më e madhe) dhe e formuluar qartë. Ajo duhet të hartohet në gjuhën angleze.

Oferta e plotë nuk duhet të kalojë 20 faqe (duke përjashtuar CV-të). Nëse tejkalohe një nga kufijtë maksimalë të faqeve, përmbajtja pas pikës së tejkalimit nuk do të përfshihet në vlerësim. Përmbajtja e jashtme (p.sh. linke të faqeve të internetit) gjithashtu nuk do të merret në konsideratë.

CV-të e personelit të propozuar në përputhje me Kapitullin 4 të ToR-ve duhet të dorëzohen duke përdorur formatin e specifikuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit. CV-të nuk duhet të kalojnë 4 faqe secila. Ato duhet të tregojnë qartë pozicionin dhe funksionin që personi i propozuar ka mbajtur në projektin referues dhe për sa kohë. CV-të mund të dorëzohen gjithashtu në gjuhën angleze.

Ju lutemi të llogaritni ofertën financiare bazuar saktësisht në parametrat e specifikuar në Kapitullin 5 “Kërkesat Kuantitative”. Kontraktori nuk ka të drejtë kontraktuale të përdorë plotësisht ditët, udhëtimet, workshopet apo buxhetet. Numri i ditëve, udhëtimeve dhe workshopeve, si dhe buxhetet, do të përcaktohen kontraktualisht si kufij maksimalë. Specifikimet për çmimet përcaktohen në preventivin e çmimeve.

Grupi i Punës konfirmon se këto Terma Reference janë hartuar në përputhje me kërkesat e projektit dhe dispozitat procedurale në fuqi.